



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 141/2 Prot.

Vlorë më, 19.01. 2024

VENDIM
Nr. 4, datë 19.01.2024

PËR
NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.37 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, DATË
06.10.2023 "PËR NJË SAKTËSIM MË VENDIMIN NR.19 TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË
PËRBASHKËT TË STUDIMIT "BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE"
MIDIS UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË DHE UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË BARIT, ITALI

Në mbështetje të nenit 49, 71, 75, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve" si dhe referuar shkresës nr.112, prot datë 15.01.2024, si dhe Vendimit nr1, të Senatit Akademik, datë 16.01.2024, prot datë 19.01.2024, në mbledhjen e datës 19.01.2024 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Te miratojë propozimin për një saktësim në vendimin nr.37, datë 06.10.2023 si më poshtë:
 - a) Riorganizimi i programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", në programin e studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike me Diplomë të dyfishtë me Universitetin Politeknik të Barit", me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), me formë studimi me kohë të plotë, në shqip dhe anglisht.
 - b) Pranimi i studentëve nga matura shtetërore bëhet në "BSc.Inxhinieri Mekanike në gjuhën shqipe".
 - c) Fillimi i implementimit të këtij programi studimi të jetë viti akademik 2024-2025
2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije MAS

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

